

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (SH.P.K.) "PREVISA" ORTAK I VETËM ME KAPITAL TË HUAJ

TIRANË

KREU I

DISPOZITA THEMELORE

Artikulli 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) "PREVISA" ORTAK I VETËM, është vazhdim i Firmsë së huaj private "PREVISA" e themeluar nga Z.Petrit Rexhepi, i biri i Shebanit, i lindur në Frespë me 22.11.1949 me shtetësi maqedonase me pasaportë Nr. KA 488488 datë 30.10.1990 dhe shtetësi shqiptare me L.Nj Nr. QH 359207 datë 17.03.1992, banues në Tiranë Rr.Mine Peza Nr.162.

Artikulli 2

Selia e SH.P.K. - së "PREVISA" është në Tiranë Rr.Mine Peza Nr.162.SH.P.K.-ja mund të hapë edhe vendqendime të tjera,përfaqësi filiale dhe agjenci në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj sipas legjislacionit të vendit ku do të hapen.

Artikulli 3

Kohëzgjatja e SH.P.K.-së është 50 vjet me të drejtë ripërtëritjetje.

SH.P.K.-ja fillon aktivitetin e saj ditën e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Artikulli 4

Aktiviteti i SH.P.K.-së "PREVISA" do të jetë: prodhim, shërbim dhe tregtim me shumicë dhe pakice, eksport dhe import të:
- Artikujve ushqimorë dhe industrialë, konfeksione, bimë medicinale dhe eterovajore, produkte bujqesore e blegtoresle dhe përpunimi i tyre
- Transport mallrash dhe udhëtarësh
- Turizëm brenda dhe jashtë vendit.
- Veprimë komisionerie, këmbizimi, ngritje linjesh dhe impiantesh.
- Shitje dhe blerje pasurish të tundeshme e të patundeshme.
- Prodhisteri të ndryshme industriale, fabrike, punishte, restorante furra buke etj.

- Marrje e dhenie kredie për vehte e për të tretë e me qfarëdolloj kushti, operacione në bursë, kambio në çdo treg financiar.
 - Hapje autoshkollësh dhe zhvillim kursesh për shoferë.
 - Hapje pikash shitjeje karburantesh të ndryshme.
 - Loja elektronike, kompjutera, hapje shkollësh për kompjutere.
 - Blerje e shitje lëndësh të para, pajisjeje e makinerie të çdo lloji.
 - Hapje poliklinike dhe farmaci dhe shitblerje pajisje mjeksore.
 - Tregtim mobilerish të ndryshme.
- Si dhe çdo veprimtari tjetër që zgjeron aktivitetin e SH.P.K.-së.

Artikulli 5

Shërbimi, selia si dhe objekti i SH.P.K.-së mund të ndryshojë pas vendimeve që mund të marrë administratori i saj.

Artikulli 6

Organ drejtues i SH.P.K.-së është ortak i vetëm i saj, administratori Z. Petrit Rexhepi. SH.P.K.-ja me vendim të ortakut të vetëm të saj mund të marrë vendim për zgjedhjen e administratorëve të tjerë.

KREU II

KAPITALI THEMELTAR

Artikulli 7

Kapitali themeltar i SH.P.K.-së është 100.000 \$ (njëqindmijë dollarë USA). Kapitali themeltar mund të shtohet apo pakësohet sipas vendimeve që merr administratori i SH.P.K.-së.

Artikulli 8

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në bazë trashëgimie.

Artikulli 9

SH.P.K.-ja ka të drejtë të çelë llogari në leke dhe valutë në bankën shqiptare dhe banke të tjera që do të hapen.

Artikulli 10

SH.P.K.-ja ka vulën e saj SH.P.K. "PREVISA" Ortek i Vetëm Eksport import Tiranë Albania. Te drejtën e përdorimit të vulës e kanë administratori dhe persona të tjerë të autorizuar prej tij. I gjithë dokumentacioni i SH.P.K.-së do të ketë emrin e administratorit firmën dhe vulën.

Neni 11

Marredheniet e punës në SH.P.K. rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12

Të punësuarit nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit që realizon SH.P.K.-ja nëse në kontratën e punës nuk është shprehur ndryshe.

Neni 13

Të punësuarit ruajnë sekretin e SH.P.K.-së edhe pas prishjes së kontratës së punës.

KRRIU III

Bilanci dhe Të Ardhurat

Neni 14

Veprimet ekonomiko financiare të SH.P.K.-së mbylleen më 31 Dhjetor të çdo viti, me nxjerrjen e bilancit financiar dhe rezultati ekonomik.

Neni 15

Kapitali i SH.P.K.-së që paraqitet si fitim neto (fitimi që rrjedh mbas shlyerjes së detyrimeve) apo si pakësim i kapitalit themelues që i përket administratorit të saj ortak i vetëm Petrit Rexhepi mund të transferohet lirisht jashtë vendit sipas nenet 12 të ligjit 7594 datë 4.08.1992.

Neni 16

Shpërbërja e SH.P.K.-së mund të vijë në çdo kohë dhe për çdo lloj shkak, si humbje kapitali, pamundësi veprimtare ose me vendim të ortakut të vetëm. Në këtë rast ai cakton një ose më shumë likuidatorë për mënyrat e likuidimit.

Neni 17

Ky statut mund të plotësohet më tej në të ardhmen sipas vendimeve të ortakut të vetëm si dhe nga ligjet e dispozitat në fuqi.
Ndryshimet dhe plotësimet në këtë statut bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë si është nxjerrë statuti.

Ky statut u përpilua në 5 (pesë) kopje të cilat nënskruhen rregullisht nga ortaku i vetëm Petrit Rexhepi.

SH.P.K. "PREVISA"
ORTAKU I VETËM

Petrit Rexhepi

Tiranë, më 9.12.1993

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA TIRANË

Nr. 20104 rep.
Në. 3594 kol.

MA 118-102-

VERTETIM

Vertetohet se sot, më datë 9.12.1993 (nëntëdhjetëtre) u paraqit personalisht para meje Shqipëri Kunti noter në këtë qytet, ortaku i vetëm i SH.P.K.-së "PREVISA" Petrit Rexhepi, me pasaportë Nr. KA 488488, madhor, me sotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili deklaroi para meje se është plotësisht dakord me këtë statut e firmosi atë para meje dhe unë noter e vertetohet rregullisht sipas ligjit.



NOTER

(Shqipëri Kunti)